



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 1169/

Tirane, date 13.15./2016

Drejtuar: **Z. DEEPIT SINGH**
SHOQERIA "SARA ALABANIA" SHPK
SHESHI SKENDERBEJ, PALLATI I KUTURES, KATI I DYTE

TIRANE

Për njoftim: **Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV**
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z. RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1571 date 18.07.2012.

I nderuar z. Singh,

Shoqëria "Sara Albania" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1571 date 18.07.2012, për mineral kromi, ne objektin "Hajdarmataj - 4", njësia administrative Bytyç, Tropoje, ne Qarkun Kukës.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.1849 date 10.02.2016, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.1169 date 11.02.2016, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1571 date 18.07.2012, për mineral kromi, ne objektin "Hajdarmataj - 4", njësia administrative Bytyç, Tropoje, ne Qarkun Kukës, për arsye se është ndërprere puna me shume se një vit. Për ndërprerjen e punës shoqëria nuk është njoftuar dhe dhëne shpjegime strukturave përgjegjëse për këtë ndërprerje, siç përcaktohet ne shkronjën "d" dhe shkronjën "dh" te nenit 18 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur ne germën "c" te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes se shfrytëzimit nr.1571 date 18.07.2012, për mineral kromi, ne objektin "Hajdarmataj - 4", njësia administrative Bytyç, Tropoje, ne Qarkun Kukës, qe shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1571 date 18.07.2012, për mineral kromi, në objektin "Hajdarmataj - 4", njësi administrative Bytyç, Tropoje, në Qarkun Kukës.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minier në Republikën e Shqipërisë" duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minier.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

